



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 64, datë 06.12.2007

**“PËR DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË SË TIRANËS, PËR
VITIN 2007, MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.23,
DATË 30.04.2007”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt. 31.07.2000, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 19, pika 9, neni 32, gërma “dh”; Ligjit Nr.8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit”, me ndryshimet përkatëse; Ligjit Nr.7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, neni 21 me ndryshimet përkatëse; Udhëzimit Nr.335, datë 17.01.2007 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007”; Udhëzimit Nr.1707, datë 02.04.2007 të Ministrisë së Brendshme “Për zbatimin e Buxhetit të Pushtetit Vendor për vitin 2007”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.23, datë 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2006 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2007”, me propozim të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë transferimin e fondeve brenda buxhetit të miratuar, sipas Tabelës Nr. 3, bashkëlidhur, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, Drejtoria e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Njësia e Zbatimit të Projekteve, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Njësia Bashkiake dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol Dervishaj

K R Y E T A R